



BASHKIMI I SINDIKATAVE TË PAVARURA TË KOSOVËS  
THE UNION OF INDEPENDENT TRADE UNIONS OF KOSOVA

Adresa:Rr. "Nëna Terezë" 35, 10 000 PRISHTINË,  
Tel/fax:++381(0)38 229 838, e-mail:bspk@etuc.org

## **Politikat Sociale në Kosovë**

**Prishtinë, 15 prill 2011** -Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Kosovës, morri pjesë në tryezën *Politikat Sociale në Kosovë: Prioritetet dhe Sfidat*, më 12 prill 2011, të organizuar nga Qendra për të Drejtat e Njeriut të Universitetit të Prishtinës. Në kuadër të kësaj tryeze u prezantuan hulumtimet, *Politikat Sociale në Kosovë: Skemat Sociale në Kontekstin Kosovar*. Ky hulumtim është realizuar nga Qendra për të Drejtat e Njeriut të UP-së dhe Qendra për Hulumtime në të Drejtat e Njeriut dhe Integritet Evropian dhe është përkrahur nga Friedrich Ebert Stiftung.

Politikat sociale nga këndvështrimi i sindikatave (BSPK-së) gjatë kësaj tryeze ishin prezantuar nga përfaqësuesja e BSPK-së Shukrije Rexhepi si: Implementimi i ligjeve ekzistuese; Ligjit mbi Sigurimin Pensional; Ligjit mbi sigurimin shëndetësor; Ligji mbi organizimin Sindikal; Sigurimi i një zhvillimi ekonomik të qëndrueshëm Gjendja sociale në Kosovë akoma vazhdon të jetë një ndër shqetësimet më të mëdha të gjithë popullatës së Kosovës. Zhvillimi i ulët ekonomik, mungesa e një strategjie të zhvillimit ekonomik është shumë e kuptueshme se reflekton dukshëm edhe në rritjen e numrit të papunësisë.

**Zyra për Informim, BSPK  
Fatma Rastelica**